



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 671/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.09.2017.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr.Ref-23154-08-03-2017 me objekt: “*Rifreskim i lyerjeve të objekteve arsimore në Bashkinë Shijak*”, me fond limit 3.704.992 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë “Erges Mat” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

Agjencia e Prokurimit Publik
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave, Tiranë

“Shendelli” sh.p.k
L. ‘Kastriot’, Rr. “Andon Profka”, “2 Kullat, Fier

“Erges Mat” sh.p.k
Rr. “Vace Zela”, Nd. 40, Shk.1, Ap.2,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shijak.
Lagja Erzen, Shijak

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 04.08.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. Ref-23154-08-03-2017 me objekt: “Rifreskim i lysterjeve të objekteve arsimore në Bashkinë Shijak”, me fond limit 3.704.992 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 25.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Erges Mat” sh.p.k	1.974.090,00 lekë, skualifikuar
2. “Cara” sh.p.k	2.274.360,00 lekë, skualifikuar
3. “Sark” sh.p.k	2.617.592,00 lekë, skualifikuar
4. “Anada” sh.p.k	2.842.850,00 lekë, skualifikuar
5. “Shendelli” shpk	3.396.390,00 lekë, skualifikuar
6. “Borova D” sh.p.k	3.497.620,00 lekë, kualifikuar
7. “Liqeni VII” sh.p.k	3.509.700,00 lekë, skualifikuar
8. “K-AAV” sh.p.k	3.627.580,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Shendelli” sh.p.k, rezulton se është skualifikuar me arsyen se:

“1. Mjeti kamiocinë në dispozicion është vetëm 1 copë ndërsa në kërkesat tona janë 2 copë, në kundërshtim me pikën 2/2.2 (për mjetet dhe pajisjet teknike të vlefshme), për kamiocinën me targë AA 074 PU, mungon leja e transportit nga Bashkia, po kështu edhe për kamiocinën me targë AA693 OY.”

Operatori ekonomik ankimues “Erges Mat” shpk, është skualifikuar pasi:

“Ju keni oferte anamalisht te ulet te paargumentuar nga ana juaj.

II.3. Në datën 29.08.2017 operatori ekonomik ankimues “Shendelli” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“A. Autoriteti kontraktor midis të tjerave kërkon në 2.2 “Kapaciteti teknik”:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten për ekzekutimin e kontratës

Nr.	Mjetet	Sasia
1.	Kamionçinë	2 copë

Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur këto mjete për plotësimin e këtij kriteri kualifikues:

- 1. Kemi dorëzuar një dokument me emërtimin ---Shendelli Kamioncin AA074PU --- i cili ka 6 (gjashtë) fletë, bashkëngjitur dokumentat Pronësia e mjetit, Certifikata e transportit (e vlefshme), Leje qarkullimi, Taksa (e vlefshme), Siguracioni (i vlefshëm).*
- 2. Kemi dorëzuar një dokument me emërtimin ---Shendelli Kamioncin AA6930Y --- i cili ka 6 (gjashtë) fletë, bashkëngjitur dokumentat Pronësia e mjetit, Certifikata e transportit (e vlefshme), Leje qarkullimi, Taksa (e vlefshme), Siguracioni (i vlefshëm).*
- 3. Kemi dorëzuar një dokument me emërtimin --- Shendelli Kamioncin AA347KE --- i cili ka 12 (dymbëdhjetë) fletë, bashkëngjitur dokumentat kontratë shitblerje, foto, tahografi, Pronësia e mjetit, Certifikata e transportit (e vlefshme), Leje qarkullimi, Taksa (e vlefshme), Siguracioni (i vlefshëm), certifikata e transportit (e vlefshme), patenta e shoferit.*

Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur më shumë manovratorë se sa autoriteti kontraktor ka kërkuar.

B. *Për kamioncinën me targë AA074PU mungon leja e transportit nga Bashkia, po kështu edhe për kamioncinën me targë AA693 OY.*

Skualifikimi nuk është i drejtë për këtë arsye. Bazuar në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 10302, datë 15.07.2010 për “Transportet rrugore”, konkretisht neni 33, licenca për këtë veprimtari i lëshohet personave fizikë ose juridikë. Kamionët me kapacitet mbartës nën 1.5 ton nuk certifikohen për transport mallrash për të tretë dhe me qira.

Bazuar në ligjin e mësipërm këto mjete nuk pajisen me certifikatë transporti sepse peshën mbajtëse e kanë më të vogël se 1.5 ton [...].”

II.3.1. Në datën 31.08.2017 nëpërmjet shkresës nr. 3001/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, autoriteti kontraktor ka sqaruar se:

“Së pari: Referenca ligjore e cituar në ankesën tuaj nuk është e saktë. Konkretisht neni 33 i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, trajton cmimet e biletave të linjave ndërkombëtare të transportit me autobus dhe të bagazheve dhe jo transportin ndërkombëtar të mallrave për të tretë dhe me qira. Referenca e saktë ligjore është Udhëzimi i Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, akt nënligjor i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, i ndryshuar, i cili në seksionin dedikuar “Transport rrugor mallrash brenda vendit” parashikon shprehimisht se “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.” Për sa u përmet më lart mjetet: kamioncinë me targë AA074PU dhe kamioncinë me targë AA693OY, që keni paraqitur në këtë procedurë prokurimi nuk janë në kushtet e zbatimit të dispozitës së lartpërmendur sepse referuar dokumentacionit shoqërues Leja e qarkullimit, Certifikatë e kontrollit teknik dhe Policë sigurimi, rezulton se të dyja këto mjete kanë një kapacitet mbajtës prej 3.500 kg/ 3.5 ton dhe rrjedhimisht duhet të certifikohen për transport mallrash nga autoriteti kompetent/bashkia”.

II.3.2. Në datën 06.09.2017 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.3.3. Në datën 15.09.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1435/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3119/1 prot., datë 13.09.2017 me objekt: “Kthim përgjigje”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.4. Në datën 29.08.2017 operatori ekonomik ankimues “Erges Mat” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike, në faqen e APP-së, si dhe në adresën e emailit të punonjësës së Bashkisë Shijak znj.P.A, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje.

II.4.1. Në datën 13.09.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.4.2. Në datën 21.09.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1462/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3164/1 prot., datë 19.09.2017 me objekt “*Kthim përgjigje*”, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së mësipërme të prokurimit. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në përfundim të afatit shtatë ditor të ankimimit, pranë Bashkisë Shijak nuk është regjistruar asnjë ankesë me shkrim nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k sipas së cilës:

“*Mjeti kamiocinë në dispozicion është vetëm 1 copë ndërsa në kërkesat tona janë 2 copë, në kundërshtim me pikën 2/2.2 (për mjetet dhe pajisjet teknike te vlefshme), për kamiocinën me targë AA 074 PU, mungon leja e transportit nga Bashkia, po kështu edhe për kamiocinën me targë AA693 OY*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se është parashikuar kërkesa si më poshtë vijon:

“*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

<i>Nr.</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Kamionçinë</i>	<i>2 copë</i>
<i>2</i>	<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>
<i>3</i>	<i>Gjenerator</i>	<i>1 copë</i>
<i>4</i>	<i>Depozite uji 5000 l</i>	<i>2 copë</i>
<i>5</i>	<i>Elektropompë</i>	<i>1 copë</i>
<i>6</i>	<i>Skeleri</i>	<i>2500 m2</i>

- *Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni dhe leja e transportit nga Bashkia (të vlefshme).*

- *Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontratë shitblerje, kontratë dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) ndersa per mjetet me qiratë paraqitet kontrata e lidhur përpara noterit e shoqëruar.”*

III.1.3. Në plotësim të kërkesës së autoritetit kontraktor për dy kamioncina, operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Leje qarkullimi për automjetin AA074PU, të llojit ATP, në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 3500 kg dhe masa e mjetit bosh 2200 kg, shoqëruar me :

- Certifikatën e kontrollit teknik, e vlefshme deri më 26 prill 2018.
- Certifikatën e pronësisë së mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, lëshuar nga Sigma Interlbanian Vjenna Insurance Group, e vlefshme deri me datë 25.04.2018.
- Taksa vjetore e mjetit, paguar me mandat nr. 10754, datë 26.04.2017.

2. Leje qarkullimi për automjetin AA693OY, të llojit ATP, në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 3500 kg dhe masa e mjetit bosh 2410 kg, shoqëruar me:

- Certifikatën e kontrollit teknik, e vlefshme deri më 19.12.2017.
- Certifikatën e pronësisë së mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, lëshuar nga Sigal Uniqa Group Austria, e vlefshme deri me datë 18.12.2017.
- Taksa vjetore e mjetit, paguar me mandat nr. 32760, datë 19.12.2016.

3. Leje qarkullimi për automjetin AA347KE, në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 4600 kg dhe masa e mjetit bosh 2655 kg, shoqëruar me :

- Certifikatën e kontrollit teknik, e vlefshme deri më 29 tetor 2017.
- Certifikatën e pronësisë së mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm mbajtësit të mjetit, lëshuar nga Eurosig sh.a, e vlefshme deri me datë 24.10.2017.
- Taksa vjetore e mjetit, paguar me mandat nr. 31526, datë 20.10.2016.
- Kontratë shitblerje datë 09.05.2016, me blerës shoqërinë “Shendelli” sh.p.k dhe shitës personin me inicialet E.K.
- Certifikatë e kryerjes së operacionit teknik për mjetin me targë AA347KE, lëshuar nga ORLU sh.p.k, Tachograph Service.
- Certifikatë lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier me datë 06.06.2017 “Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet”, e vlefshme deri më 05.06.2022.
- Patenta e shoferit.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i

vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka dorëzuar Leje qarkullimi për automjetin AA693OY, të llojit ATP, në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 3500 kg dhe masa e mjetit bosh 2410 kg, Certifikatën e kontrollit teknik, e vlefshme deri më 19.12.2017, për mjetin me targë AA693OY, Certifikatën e pronësisë së mjetit me targë AA693OY, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit me targë AA693OY, lëshuar nga Sigal Uniqa Group Austria, e vlefshme deri me datë 18.12.2017, Taksa vjetore e mjetit me targë AA693OY, paguar me mandat nr. 32760, datë 19.12.2016. Gjithashtu ka dorëzuar Leje qarkullimi për automjetin AA074PU, të llojit ATP, në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 3500 kg dhe masa e mjetit bosh 2200 kg, shoqëruar me Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin me targë AA074PU, e vlefshme deri më 26 prill 2018, Certifikatën e pronësisë së mjetit me targë AA074PU, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit me targë AA074PU, lëshuar nga Sigma InterAlbanian Vjenna Insurance Group, e vlefshme deri me datë 25.04.2018, Taksa vjetore e mjetit me targë AA074PU, paguar me mandat nr. 10754, datë 26.04.2017. Përveç dokumentacionit për dy kamioncinat e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion edhe për automjetin me targë AA347KE si; Leje qarkullimi në emër të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, sipas të cilës masa maksimale e autorizuar e mjetit është 4600 kg dhe masa e mjetit bosh 2655 kg, Certifikatën e kontrollit teknik, e vlefshme deri më 29 tetor 2017, Certifikatën e pronësisë së mjetit, Policë për sigurimin e detyrueshëm mbajtësit të mjetit, lëshuar nga Eurosig sh.a, e vlefshme deri me datë 24.10.2017, Taksën vjetore e mjetit, paguar me mandat nr. 31526, datë 20.10.2016, Kontratën e shitblerjes datë 09.05.2016, me blerës shoqërinë “Shendelli” sh.p.k dhe shitës personin me inicialet E.K, Certifikatën e kryerjes së operacionit teknik për mjetin me targë AA347KE, lëshuar nga ORLU sh.p.k, Tachograph Service, Certifikatën e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier me datë 06.06.2017 “Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet”, e vlefshme deri më 05.06.2022.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët,

nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nga ana tjetër, operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e kërkuara në dokumentat e tenderit e në rastin konkret të vërtetojnë se disponojnë të paktën dy kamioncina me qëllimin e vetëm për të bërë të mundur zbatimin e kontratës për rifreskimin e lyerjeve të objekteve arsimore në Bashkinë Shijak, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacion se disponon tre kamioncina nga të cilat dy janë kontestuar nga autoritetit kontraktor me pretendimin se kapaciteti i tyre mbajtës është i tillë që duhet të certifikohen për transport mallrash nga autoriteti kompetent/bashkia, pasi e tejkalon kapacitetin e parashikuar në legjislacionin në fuqi për këtë rast. Më saktësisht në përgjigjen e kthyer operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 3001/1 prot., datë 31.08.2017, AK-ja është shprehur: “[...]Referenca e saktë ligjore është Udhëzimi i Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, akt nënligjor i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, i ndryshuar, i cili në seksionin dedikuar “Transport rrugor mallrash brenda vendit” parashikon shprehimisht se “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.” Për sa u përmond më lart mjetet: kamioncinë me targë AA074PU dhe kamioncinë me targë AA693OY, që keni paraqitur në këtë procedurë prokurimi nuk janë në kushtet e zbatimit të dispozitës së lartpërmendur sepse referuar dokumentacionit shoqëruar Leja e qarkullimit, Certifikatë e kontrollit teknik dhe Policë sigurimi, rezulton se të dyja këto mjete kanë një kapacitet mbajtës prej 3.500 kg/ 3.5 ton dhe rrjedhimisht duhet të certifikohen për transport mallrash nga autoriteti kompetent/bashkia.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, neni 46, përcaktohet se: “Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg”, ndërsa në Udhëzimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, thuhet se, kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k, vërteton plotësisht kapacitetin teknik të këtij subjekti përsa i përket plotësimin të kërkesës së autoritetit kontraktor për mjetet kamioncina, në përputhje me nenin 46 të LPP-së, pasi kapaciteti transportues i kamioncinave me targë AA693OY dhe AA074PU është më i vogël se 1500 kg e në këto kushte përjashtohen nga pajisja e tyre me certifikatë transporti, bazuar në ligjin për transportet rrugore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si më sipër cituar.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në 25.08.2017 operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave, ofertuesit e skualifikuar si dhe arsyet konkrete të skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij.

III.2.2. Në datën 29.08.2017 operatori ekonomik ankimues “Erges Mat” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike, në faqen e APP-së, si dhe në adresën e emailit të punonjësës së Bashkisë Shijak znj. P.A, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

III.2.3. Në datën 13.09.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu ankimuesi pretendon se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje.

III.2.4. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor nr. 3164/1 prot., datë 19.09.2017 rezulton se në përfundim të afatit shtatë ditor të ankimimit, pranë Bashkisë Shijak nuk është regjistruar asnjë ankesë me shkrim nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.2.6. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k pranë autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kjo ankesë është dërguar elektronikisht në AK si dhe në adresën e emailit të punonjësës së Bashkisë Shijak znj.P.A. Referuar *lex specialis* LPP, neni 63 pika 2 ku parashikohet se “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 78 pika 6 ç) shprehimisht përcaktohet se: “Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të

ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit”.

Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike”. Në nenin 22 të LPP-së parashikohet se: “I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë ligj bëhen me shkrim ose me mjete elektronike”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit me shkrim, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, dorëzimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj., por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike. Akoma më tej, K.P.P. gjykon se dorëzimi i ankesës me mjete elektronike nuk gjen zbatim në kuptim të LPP-së. K.P.P. gjykon që komunikimi me anë të dokumentit elektronik të përmbushë kushtet e vlefshmërisë së tij, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i cili njëherazi duhet të jetë administruar, protokolluar pranë insitucionit përkatës në përputhje me VKM nr.357 datë 24.04.2013 “Për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë”.

III.2.7. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i formës ligjore të ankesës, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor me anë të komunikimit elektronik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik përkatësisht datë 13.09.2017 nuk legjitimohet pasi operatori ekonomik nuk ka ezauruar të gjitha shkallët që duhet të ndjekë një ankim administrativ parashikuar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” shpk për procedurën e prokurimit me Nr.Ref-23154-08-03-2017 me objekt: “Rifreskim i lyerjeve të objekteve arsimore në Bashkinë Shijak”, me fond limit 3.704.992 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 14.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomikë “Shendelli” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi brenda 10 ditëve, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1435 Prot;

Nr. 1462 Prot;

Datë 06.09.2017

Datë 13.09.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha